92	20.12.2024	Doja te dija nese keni ndonje format te thjeshte instruktimi per aplikim per mbrojtje marke si individ dhe/ose si PF pasi tek e-Albania duket e komplikuar dhe per me teper nuk dime cilen fushe te zgjedhim per te filluar aplikimin.	20.12.2024	Në vijim të emailit tuaj, bashkëngjitur gjeni informacion në lidhje me aplikimin për regjistrimin kombëtar të markës tregtare. Gjithashtu, në rast nevojë ose paqartësie, mund të kërkonë ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të licencuar nga DPPI-ja, të cilët janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës së pronësisë industriale. Listën e tyre e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://dppi.gov.al/e-sherbime/regjistri-i-perfaqesueseve-te-autorizuar	Email	0
93	29.01.2025	Bazuar në ligjin Nr.118/2014 Për të Drejtën e Informimit, Neni 3 E drejta e informimit, kërkoj të informohem se : 1. Cilat janë arsyet që Regjistri i Objekteve të Pronësisë Industriale nuk përditësohet rregullisht në mënyrë që të interesuarit të njihen në kohë reale me statusin e aplikimit të tyre? 2.Të njihen në kohë reale me afatet e publikimit të aplikimeve që bijen	29.01.2025	1. Për t'iu përgjigjur saktë pyetjeve tuaja (1) dhe (2) : <i>"1. Cilat janë arsyet që Regjistri i Objekteve të Pronësisë Industriale nuk përditësohet rregullisht, në mënyrë që të interesuarit të njihen në kohë reale me statusin e aplikimit të tyre? 2.Të njihen në kohë reale me afatet e publikimit të aplikimeve që bien ndesh me interesat e tyre dhe që bazuar në</i>	E-mail i perfunduar	0

		ndesh me interesat e tyre dhe që bazuar në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 " Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar të bëjnë kundërshtimin e tyre brenda afateve? 3. Ka ndonjë kalendar ose afate të përcaktuara për përditësimin e këtyre të dhënave? 4. Sa është numri i punonjësve që janë të angazhuar me këtë procedurë? 5. Cili është departamenti apo sektori përgjegjës për këtë? 6. Nëse ky përditësim është i pamundur të kryhet në kohë reale, ose brenda afateve të arsyeshme, atëherë për çfarë shërben dhe a konsiderohet nga ju si shkelje?		ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 " Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar të bëjnë kundërshtimin e tyre brenda afateve? ”; <u>kemi nevojë të na sqaroni:</u> • Cili është rasti konkret, apo cilat janë rastet konkrete që ju kanë bërë ju të arrini në këtë konkluzion? Pra, për cilin objekt konkret të PI-së keni bërë kërkim në regjistrin <i>on-line</i>, apo në rubrikën “<i>Buletini i Pronësisë Industriale</i>” në faqen web <i>dppi.gov.al</i>, e në këtë rast informacioni ju ka rezultuar i papërditësuar? • Mbi të gjitha, në ndihmë të përmirësimit të shërbimit tonë ndaj publikut, ju lutemi, çfarë nënkuptoni me <u>përditësim rregullisht</u> të Regjistrit të Objekteve të Pronësisë Industriale, dhe në cilat akte /		
--	--	---	--	---	--	--

				dispozita ligjore bazohet? Nga ana jonë, paraprakisht përgjigjeve sqaruese të pyetjeve tona më lart, që do na vini në dispozicion, ju bëjmë me dije se aktualisht, kompania e mirëmbajtjes së sistemit online, e kontraktuar nga AKSHI, ndër të tjera edhe për shërbimin e përditësimit periodik të databazës, na raporton se përditësimi i informacionit të Regjistrit të Objekteve të Pronësisë Industriale realizohet çdo 24 orë, përveç rasteve kur ndodh ndonjë defekt teknik. Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, DPPI-ja publikon Buletinin e Pronësisë Industriale në faqen zyrtare të Internetit, të paktën një herë në muaj. Sa më sipër, fakti që për vitin e 2024 janë publikuar 34 Buletine, si dhe fakti që vetëm për muajin janar 2025 janë publikuar 3 Buletine, do të thotë se DPPI-ja e ka përmbushur më së miri këtë detyrim ligjor. Lidhur me këtë çështje, këshillojmë çdo subjekt të interesuar, që nëse harxhon 5 minuta të kohës së vet, të paktën një herë në muaj,		
--	--	--	--	---	--	--

				për të kërkuar në buletinet e botuara në faqen tonë web për aplikime që mund të bien ndesh me interesat e tyre të ligjshme, do të ishte zero probabiliteti i mbetjes pa informacion. Pra, publikimi periodik që DPPI-ja i bën Buletinit të PI-së, krijon mundësinë e plotë për të reaguar e vepruar brenda afatit ligjor në mbrojtje të këtyre interesave. 2. Në sqarimet më sipër gjeni edhe përgjigjen e pyetjes suaj “<i>Ka ndonjë kalendar ose afate të përcaktuara për përditësimin e këtyre të dhënave?</i>”. 3. Në përgjigje të pyetjeve tuaja (4) dhe (5) “4. <i>Sa është numri i punonjësve që janë të angazhuar me këtë procedurë?</i> 5. <i>Cili është departamenti apo sektori përgjegjës për këtë?</i>”; ju bëjmë me dije se në proceset e reflektimit të të dhënave, përditësimi të tyre në regjistrat online,		
--	--	--	--	--	--	--

				në përgatitjen dhe publikimin e Buletinit të PI-së, për aq sa i përket pjesës që DPPI-ja ka detyrim të kryejë, janë të ngarkuar punonjës në varësi të Drejtorisë së Ekzaminimit dhe të Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës. 4. Në përgjigje të pyetjes suaj 6 : <i>“Nëse ky përditësim është i pamundur të kryhet në kohë reale, ose brenda afateve të arsyeshme, atëherë për çfarë shërben dhe a konsiderohet nga ju si shkelje?”</i>, kërkoj më edhe njëherë nga ju të na vendosni në dispozicion për cilën shkelje konkretisht bëhet fjalë? -Në vijim të këtij informimi dhe bazuar në parimet e së drejtës, ku asnjë akuzë nuk mund të bëhet pa u identifikuar objekti konkret i shkeljes dhe subjekti i dëmtuar,		
--	--	--	--	--	--	--

				DPPI-ja kërkon nga ju të na informoni konkretisht se cilat janë objektet konkrete të shkeljeve, në mënyrë që duke marrë shkas nga shqetësimi që ju përcillni, të iniciojmë një hetim administrativ lidhur me çdo shkelje të pretenduar.		
94	05.02.2025	Do bëj transferim të dy markave nga një Shoqëri në një Shoqëri tjetër nëpërmjet një Deklarate Noteriale për transferim të pronësive, në Deklarate do përcaktohet që bashkë me transferimin do bëhet dhe procedura e ripërteritjes së markave. Duke qenë se aplikimi i transferimit do bëhet nga e-albania e shoqërisë transferuese dhe do të jetë në proces, aplikimin për ripërteritje markë mund ta bëj nga llogaria në e-albania e shoqërisë që pritet të kalojë në pronësi? Në rast se nuk mund ta bëj nga shoqëria e re për atë kohë sa procesi nuk ka përfunduar, mund të vijoj	06.02.2025	Sikurse ju kemi informuar edhe verbalisht në bisedë telefonike, çdo kërkesë mund të drejtohet nga një përfaqësues i autorizuar, me kusht që përfaqësuesi të deklarojë se po aplikon si i tillë në formularin online.	E-mail i përfunduar	0

		aplikimi nga nje perfaqesues i shoqerive me Prokure ne llogarine e tij ne e-albania? Ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj,				
95	12.02.2025	Kam kryer aplikimin online per regjistrimin e nje marke dhe me ka ardhur pergjigja prej DPPI qe duhet te kryej plotesimin e te metave, te cilat lidhen me disa sakesime te zerat e nenklasave. Pyetja ime eshte: Ku mund te bej plotesimin e ketyre te metave, pasi nuk gjej asnje opsion te e-Albania per nje procedure te tille ? Kam kerkuar per ndonje manual te DPPI, por nuk kam gjetur.	12.02.2025	Në lidhje me përdorimin e sistemit komunikoni me helpdesk@e-albania.al.	E-mail i perfunduar	0
96	12.02.2025	Na duhet te regjistrojme nje MARK.	12.02.2025	Bashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me regjistrimin e një marke. Gjithashtu, në rast nevojë ose paqartësie, ju mund të kërkonë ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të certifikuar nga DPPI-ja, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e	E-mail i perfunduar	0

				përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://regjistriperfaqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html .		
97	12.02.2025	Sipas informacionit në portalin unik E-Albania, lidhur me "kostot e aplikimit të ripërtëritjes së markës tregtare", rezulton se: <u>"8000 lekë për kërkesë për ripërtëritjen e markës</u> <u>Për çdo klasë shtesë 4000 lekë dhe depozitimi në periudhën gjashtë mujore nga data e përfundimit të periudhës së mbrojtjes 4000 lekë".</u> 2 - Për sa më sipër, nëse aplikanti ndodhet brenda afatit 6-mujor nga përfundimi i afatit të mbrojtjes së markës tregtare, sa do të jetë tarifa e kësaj procedure?	12.02.2025	Në vijim të email-it tuaj, lutemi të bëni llogaritjen e pagesës duke ju referuar VKM nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", i ndryshuar, të cilin e gjeni bashkëngjitur.	E-mail i perfunduar	0
98	13.02.2025	We beg to inform us whether we can pay in Albania the 5th annuity on behalf of the clients or we have	13.02.2025	In response to your email, I inform you that subjects who do not have permanent residence in the Republic of Albania or who do not carry out activities in its territory,	E-mail i perfunduar	0

		to charge an Albanian agent to pay these fees. In affirmative case, we beg to send us the payment instructions. We thank you for your reply and we remain		can apply to the GDPI only through the intermediation of Albanian authorized representatives of PI. So, you have to appoint an Albanian representative certified as such by the GDPI. I'm sending you the link to the Register of Representatives on our web page: http://regjistriperfaqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html . Once the page is open, you have to click on the writing: Klikoni këtu për të hapur Rregjistrin. After that, the list of all representatives will appear. You can find comprehensive information in English (including the amended law no. 9947, date 07.07.2008 "On Industrial Property") on our web page: dppi.gov.al.		
99	16.02.2025	Jam i interesuar per informacion rreth regjistrimit te markave tregtare. Duke qene se jam ne proces organizimi per celjen e subjekti tregtar person juridik, me nevojitet nje	17.02.2025	Markat janë objekte të pronësisë intelektuale dhe si të tilla i takojnë ligjërisht krijuesit të tyre, pra parimisht ato mund të regjistrohen vetëm nga mbajtësi i tyre ligjor. Në përgjigje të pyetjeve tuaja (1) dhe (2), me aq informacion sa na vendosni në dispozicion, konstatojmë se me	E-mail i perfunduar	0

		informacion paraprak. 1. A eshte e mundur qe nje individ, nenshtetas i huaj te aplikojte per regjistrimin e markes ne emrin e tij dhe subjekti juridik i siperpermendur te autorizohet nga ky individ te perdore kete marke? 2. Nje marke e regjistruar ne BE, mund te regjistrohet ne Shqiperi, nese kompania e huaj jep ekskluzivitet per kete marke? 3. Cilat jane tarifat dhe afatet e regjistrimit te markes ne Shqiperi per rastet e permendura me lart? Duke ju falenderuar paraprakisht, do vleresoja nje pergjigje nga ana Juaj!		pronarin e markave për të cilat flisni, ju keni marrëveshje licencimi për përdorimin e markave në territorin shqiptar. Në këto kushte: 1- Nëse markat janë të regjistruara në territorin shqiptar, mund të regjistrohet në DPPI nëpërmjet platformës “e-Albania” kontrata e licencës, ku ju të rezultoni si subjekti i licencuar nga pronari i markës për përdorimin e saj, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar dhe në nenet 33 e 34 të VKM nr. 315, datë 31.5.2018 “Për miratimin e rregullores për markat” i ndryshuar. Për secilën markë aplikohet me aplikim të veçantë. 2- Nëse markat nuk janë të regjistruara në territorin shqiptar, pronari i tyre duhet t’i regjistrojë njëherë ato dhe pasi të jetë kryer regjistrimi, mund të regjistrohet në DPPI nëpërmjet platformës “e-Albania”, kontrata e licencës ku ju të rezultoni si subjekti i licencuar nga pronari i markës për përdorimin e saj, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë	
--	--	--	--	---	--

				Industriale” i ndryshuar dhe në nenet 33 e 34 të VKM nr. 315, datë 31.5.2018 “Për miratimin e rregullores për markat” i ndryshuar). Për secilën markë aplikohet me aplikim të veçantë. -Aplikimi për regjistrimin e një marke, mund të depozitohet në DPPI nëpërmjet platformës unike qeveritare “e-Albania”. Një subjekti të huaj, jorezident në Republikën e Shqipërisë ose që nuk kryen aktivitet tregtar brenda territorit të saj, <i>mund të aplikojë vetëm i përfaqësuar nga përfaqësues të autorizuar, të regjistruar në këtë drejtori.</i> Më poshtë gjeni linkun që ju mundëson të aksesoni regjistrin e përfaqësuesve të PI-së, të regjistruar në DPPI: - Një subjekt i huaj, jorezident në Republikën e Shqipërisë ose që nuk kryen aktivitet tregtar brenda territorit të saj, mund të aplikojë për regjistrimin e një marke në territorin shqiptar edhe nëpërmjet një regjistrimi ndërkombëtar në WIPO, bazuar në Marrëveshjen e Madridit dhe në Protokollin e Marrëveshjes së Madridit “Për regjistrimin ndërkombëtar të markave		
--	--	--	--	--	--	--

				tregtare”. Në këtë rast, kontrata e licencës regjistrohet direkt në zyrën ndërkombëtare të WIPO-s, bazuar në marrëveshjen e sipërcituar. 2- <u>Ju, mund të regjistroni markat për të cilat interesoheni, në emrin tuaj, vetëm nëse pronari i tyre ju jep juve shprehimisht të drejtën me dokument ligjor, që të bëheni pronar i vetëm i tyre në territorin shqiptar, në kuptim të nenit 156 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar.</u> 3- Në përgjigje të pyetjes suaj "Cilat jane tarifat dhe afatet e regjistrimit te markes ne Shqiperi per rastet e permendura me lart?", ju lutemi referohuni në faqen tonë web <u>dppi.gov.al</u> , VKM nr. 883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale" të ndryshuar, si dhe për më tepër për procedurat e regjistrimit të markave, gjeni bashkëngjitur një material informues. <u>Ju bëjmë me dije në vijim të sa më sipër, se në rast nevojë ose paqartësie, ju mund të kërkonit ndihmën e një prej përfaqësuesve të</u>		
--	--	--	--	--	--	--

				<u>autorizuar, të regjistruar në DPPI, që janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës, listën e të cilëve e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://regjistriperfaqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html.</u>		
100	17.02.2025	Do tju isha shume falenderues une dhe shume qytetar te tjere pasi keto produkte po rrezikojn shendetin tone. Para disa ditesh kam bler nje produkt shampo Head and shoulder por ne momentin e blerjes nuk jam treguar i kujdesshem te dalloja nese ky produkt ishte i fallcifikuar. Duke qen se dhe produkti i meparshem qe kam pasur ishte identik kam arritur te dalloj se ngjyra e solucionit te shampos ishte shume me e theksuar dhe kjo me beri te dyshoja se produkti ishte i fallcifikuar. Me pas kam dalluar she shume ndrushime te imta ne pjesen e	17.02.2025	Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju bëjmë me dije si vijon: Në bazë të nenit 189, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar, <i>Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucion publik që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI.</i> Bazuar në sa më sipër, DPPI-ja në asnjë rast nuk ka kompetencë monitorimin e përdorimit të gabuar të markave të ndryshme në treg, apo marrjen e masave për mbrojtjen e tyre nga përdorimi i paligjshëm. <u>Asnjë dispozitë ligjore nuk përcakton inspektimin apo ndalimin e produkteve që përmbajnë shenja dalluese të falsifikuara, si detyrë e kompetencë lëndore të DPPI-së.</u>	E-mail i perfunduar	0

		amballazhit te cilat perfshijn: Printim jo i qart inpjeses se QR code, printimi i fsheht ne brendesi te tapes qe mungonte ne produktin fallco si dhe phesa e ngjyries se brendshme te amballashit qe bungonte ne produktin fallco. Po ju dergoj disa foto krahasuese.		Në mbrojtje të të drejtave tuaja si konsumator, lutemi, drejtohuni në Institucionet si më poshtë: 1. Në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut. https://ishmt.gov.al/siguria-e-produkteve-hyrje . 2. Në Drejtorië e Përgjithshme të Doganave, nëse mallrat janë të importuara. https://www.dogana.gov.al/c/178/mallrat-e-falsifikuara-dhe-pirate . 3. Në Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit në Bashkinë Tiranë, ose duke u ankuar <i>online</i> në faqen web https://mbrojtjakonsumatorit.tirana.al/ . 4. Në Policinë e Shtetit dhe në Prokurori, në bazë të Kodit Penal të RSH. 5. Në gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në bazë të neneve 184 e vijuese të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë	
--	--	---	--	--	--

				industriale" i ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (RSH) për shpërblimin e dëmit.		
101	19.02.2025	Lutemi per nje informacion per sa me poshte: 1.Kerkojme te bejme regjistrim te nje marke tregtare per nje person fizik PF. Mundemi ta bejme aplikimin nderkohe qe aktiviteti i subjektit eshte i pezulluar? 2.Po ne kushtet kur personi eshte shtetas i huaj me leje qendrimi ne Shqiperi, mundet ai te leshoje prokure per te autorizuar dike tjeter per kryerjen e aplikimit per regjistrimin e markes tregtare?	19.02.2025	Në përgjigje të pyetjes suaj, ju informojmë se dispozita ligjore që rregullon përfaqësimin në DPPI, është neni 195 i ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë Industriale" i ndryshuar.	E-mail I perfunduar	0
102	21.02.2025	A duhet te keme një nipt për te regjistruar një mark rrobash ? pasi jame në fazën e projekt pilotit.	27.02.2025	Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se aplikimi për regjistrimin e markës tregtare kryhet edhe nga një person fizik, domethënë individ pa NIPT, por me kartë identiteti.	E-mail I perfunduar	0
103	27.02.2025	Pershendetje,si jeni?kam Futur nje detergjent te ri ne treg,dhe dua ta	28.02.2025	Bashkëngjitur gjeni materialin informues për regjistrimin e patentës për shpikje.	E-mail I perfunduar	0

		Patentoj,si Mund te veproj?				
104	01.03.2025	Po shqyrtoj mundësinë e aplikimit për një markë tregtare ndërkombëtare dhe do të doja të merrja informacion mbi hapat e nevojshëm për këtë proces. Më konkretisht, do të doja të di: 1. A duhet që fillimisht të aplikoj për regjistrimin e markës kombëtare në Shqipëri dhe vetëm pas regjistrimit të saj të vazhdoj me aplikimin ndërkombëtar? 2. A ekziston mundësia që të aplikohet drejtpërdrejt për një markë ndërkombëtare pa pasur një aplikim ose regjistrim të mëparshëm në Shqipëri? Do të vlerësoja çdo informacion mbi	04.03.2025	Përshëndetje, Bashkëngjitur gjeni materialin informues për regjistrimin e një marke ndërkombëtare.	E-mail i perfunduar	0

		procedurat, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet për secilën mundësi. Ju falënderoj për kohën dhe ndihmën tuaj dhe pres me interes përgjigjen tuaj.				
105	06.03.2025	Sapo kam hapur nje biznes shpk ne fushen e restoranteve dhe fastfoodeve. Kam vendosur emrin tregtare qe ne krijim ne QKB. Dua qe logon e restorantit tim te cilen e kam dizenjuar ta kem vetem une dhe te jete e mbrojtur nga perdorimi i te tjereve. Ju lutem si duhet te veprojm? Per sa kohe merret ?	06.03.2025	Përshëndetje, Për t'u informuar në lidhje me procedurën e regjistrimit të një marke, bashkëngjitur gjeni materialin informues. Ju faleminderit!	E-mail i perfunduar	0
106	12.03.2025	Po ju drejtohem me kërkesën për të marrë disa informacione në lidhje me procedurat e regjistrimit të një marke (logoje) televizive. Do të isha mirënjohës/e nëse mund të më informoni për hapat që duhet të ndjek për të realizuar këtë proces.	17.03.2025	Përshëndetje, Bashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me procedurën e regjistrimit të markës tregtare. Ju faleminderit!	E-mail i perfunduar	0

107	17.03.2025	Dua të bëj aplikim për të mbrojtur një logo, e cila përbëhet nga shkronja dhe një simbol. Simboli dhe shkronjat kane ngjyra te ndryshme.	17.03.2025	Bashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me aplikimin për regjistrim marke.	E-mail I perfunduar	0
108	20.03.2025	Në vijim të komunikimit dëshiroj të shpreh interesin tim për t'u trajnuar pranë DPPI dhe për t'u kualifikuar e certifikuar si ekspert/person i autorizuar për marka, patenta dhe tregues gjeografikë. Lutem të më informoni mbi hapat që duhet të ndjek dhe dokumentacionin e nevojshëm paraprak për këtë proces.	21.03.2025	Ne vijim te emailit tuaj, ju informojmë se ju duhet të aplikoni në e-Albania (ku gjeni informacion në lidhje me procedurën) shërbimet "Aplikim për pjesëmarrje në trajnim në Qendrën e Trajnimeve të Pronësisë Industriale në DPPI" për t'u trajnuar dhe "Aplikim për pajisje me certifikatë si përfaqësues i autorizuar/ekspert i pronësisë industriale", për t'u certifikuar.	E-mail I perfunduar	0
109	28.03.2025	Jam i interesuar te mbroj nje ide biznesi qe kam pa filluar diskutimet me investitore te mundshem. Pra dua te di nese eshte e mundur qe ligjerisht te mbroj iden time duke mos ju len mundesi investitoreve te formojne kte produkt pa	01.04.2025	Duke qene se nga emaili juaj, nuk arrihet të dallohet qarte cili është objekti i pronësisë industriale për të cilin kërkohet informacioni, bashkëngjitur gjeni legjislacionin për procedurën e patentës për shpikje dhe modeleve të përdorimit, markave tregtare dhe disenjove industriale. Në rast nevojë ose paqartësie, mund të	E-mail I perfunduar	0

		miratimin ose perfitimin tim.		kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të certifikuar nga DPPI-ja, të cilët janë profesionistë të lire, specialistë të fushës së PI. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://regjistriperfaqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html .		
110	28.03.2025	Jam i interesuar të mbroj një ide biznesi që kam pa filluar diskutimet me investitorë të mundshëm. Pra dua të di nëse është e mundur që ligjerisht të mbroj iden time duke mos ju lënë mundësi investitorëve të formojnë këtë produkt pa miratimin ose perfitimin tim.	01.04.2025	Duke qenë se nga emaili juaj, nuk arrihet të dallohet qartë cili është objekti i pronësisë industriale për të cilin kërkohet informacioni, bashkëngjitur gjeni legjislacionin për procedurën e patentës për shpikje dhe modele të përdorimit, markave tregtare dhe disenjove industriale. Në rast nevojë ose paqartësie, mund të kërkoni ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të certifikuar nga DPPI-ja, të cilët janë profesionistë të lire, specialistë të fushës së PI. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://regjistriperfaqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html .	E-mail i perfunduar	0

111	07.04.2025	Ju shkruaj pasi interesohem te di informacion te hollesishem mbi legjislacionin perkates per regjistrimin e nje marke birre ne Shqiperi , duke nisur nga dokumentat qe duhen dhe cdo gje tjeter shtese dhe ku behet aplikimi.	09.04.2025	Bashkëngjitur gjeni materialin informues për regjistrimin e markës tregtare.	E-mail I perfunduar	0
112	09.04.2025	Po iu drejtohem i ne lidhje me tarifen e transformimit te regjistrimit nderkombetar ne aplikim kombetar te markes tregtare. Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 883, date 13.05.2009, <i>“Per miratimin e tarifave per regjistrimin e objekteve te pronesise industriale”</i>, i ndryshuar, kuptojme se tarifa zyrtare per aplikimin per transformimin e regjistrimit nderkombetar ne aplikim kombetar te markes tregtare eshte <u>7,000 leke.</u> Lutem konfirmoni nese, pervec kesaj tarife, ekzistojne	10.04.2025	Tarifat që aplikohen për transformimin e regjistrimit të aplikimit ndërkombëtar, në aplikim kombëtar të markës tregtare janë të njëjta me ato të aplikimit kombëtar, pra tarifë për klasën e parë dhe për çdo klasë shtesë si në VKM nr. 883, date 13.05.2009, <i>“Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”</i> , i ndryshuar.	E-mail I perfunduar	0

		tarifa te tjera zyrtare shtese (p.sh. per klasat shtese te mallrave/sherbimeve), qe duhet te merren parasysh ne kete proces.				
113	14.04.2025	Doja te kisha informacion rreth procedurave qe duhen ndjekur per regjistrimin e markes	14.04.2025	Bashkëngjitur gjeni materialin informues për regjistrimin e markës tregtare.	E-mail i perfunduar	0
114	17.04.2025	Kerkoje informacion mbi rregjistrimin e markave dhe te Logove si dhe tarifat e aplikimit	17.04.2025	Bashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me regjistrimin e markës tregtare.	E-mail i perfunduar	0
115	25.04.2025	Përshëndetje, Jam i interesuar të aplikoj për një patentë për shpikje pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe do të doja të di më shumë rreth procedurës së aplikimit, dokumentacionit të nevojshëm dhe mundësisë për të paraqitur dokumentet fizikisht në zyrën tuaj. Do të isha mirënjohës nëse mund të më informoni për:	28.04.2025	Çdo aplikim kryhet online në portalin e-Albania. Lista e dokumenteve që duhet të dërgohen me postë në DPPI, sipas vendimit nr.4 të Këshillit Mbikqyrës së DPPI (të cilën e gjeni bashkëngjitur), për miratimin e vendimit "Përcaktimin e kushteve, afateve dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, nëpërmjet platformës e-Albania", është: -Autorizimet e përfaqësimit, ose prokurat; -Kontratat e licensës dhe kontratat e transferimit të pronësisë; -Çdo dokument provues që legjislacioni kërkon të jetë original apo i noterizuar;	E-mail i perfunduar	0

		Orarin e pritjes për dorëzimin fizik të dokumenteve Tarifat dhe mënyrat e pagesës A është e nevojshme të caktohet takim paraprak Lista e dokumenteve që duhet për aplikimin paraprak		-Pretendimet e noterizuara; -Dokumentet provuese që legjislacioni parashikon të depozitohen origjinale ose të noterizuara. -Akte noteriale. Pagesa kryhet vetëm në BKT dhe duke përdorur faturën për arkëtim, të cilën e gjeni bashkëngjitur në këtë email, si dhe në çdo shërbim në platformën e-Albania. Për tarifat bashkëngjitur gjeni VKM nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale”, i ndryshuar. Gjithashtu, bashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me regjistrimin e patentës për shpikje. Përcjellja e informacionit si më sipër, kryhet pa qenë e nevojshme që të rezervoni një takim paraprak.		
116	25.04.2025	Jam e interesuar për te regjistruar marke tregtare prane DPPI. Ju lutem ndani informacionin ne lidhje me procesin e regjistrimit te markes; psh: 1. Ne rsatin e aplikimit te nje	28.04.2025	Në vijim të emailit tuaj, bashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me regjistrimin e markës tregtare.	E-mail i perfunduar	0

		shtetasi shqiptar, cilat jane procedurat e aplikimit. 2. Ne rastin e nje aplikanti te huaj cila eshte procedura e aplikimit? 3. Sa jane kostot perkatese per secilin aplikim? 4. Nese e keni te mundur na ndihmoni me proceduren hap pas hapi per te dyja rastet (shtetas shqiptar dhe i huaj)				
117	28.04.2025	Nese eshte e mundur do doja te kisha nje informacion rreth aplikimit qe duhet te beje per regjistrimin e markes, si dhe tarifat qe duhen paguar.	28.04.2025	Në vijim të emailit tuaj, bashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me regjistrimin e markës tregtare. Tarifat i gjeni në VKM nr.883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale”, i ndryshuar (bashkëngjitur).	E-mail i perfunduar	0
118	28.04.2025	Jam e interesuar per nje informacion te detajuar mbi menyren e aplikimit dhe celjes se nje brendi(marke). Nese do mundeni te me krijoni nje hapsire .	28.04.2025	Në vijim të emailit tuaj, bashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me regjistrimin e markës tregtare.	E-mail i perfunduar	0
119	28.04.2025	Ju shkruaj për të kërkuar informacion lidhur	28.04.2025	Në bazë të pikës 6, të nenit 145, të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008	E-mail i perfunduar	0

		me procedurat e aplikimit në rastin kur një markë është e regjistruar pranë regjistrit të markave dhe patentave për një klasë të caktuar (për shembull për veshje në klasën e Nices 25) dhe synohet që të zgjerohet përdorimi i saj edhe në një klasë tjetër. (si p.sh. klasa 15 për bizhuteri) Në këtë rast, a është e nevojshme që të kryhet një aplikim i ri nga fillimi për markë sëbashku me klasën e re (klasa 15), apo ekziston një procedurë e veçantë për shtesën e klasës tek marka ekzistuese? Faleminderit paraprakisht për ndihmën dhe informacionin që mund të më ofroni.		“Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, <u>"Pas datës së lëshimit të dëshmisë së depozitimit nga DPPI-ja, ndalohej të bëhen shtesa në listën e mallrave ose shërbimeve apo ndryshime në pamjen e markës, përveç rasteve që lidhen me bërjen e korrigjimeve ortografike ose saktësimeve në listën e mallrave ose shërbimeve."</u>, si dhe në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit 161, të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, <u>"Marka e regjistruar në regjistrin e markave të DPPI-së nuk ndryshohet gjatë kohëzgjatjes së regjistrimit dhe as me ripërtëritjen e saj. Megjithatë, kur ndryshimi ka të bëjë me emrin dhe adresën e pronarit të markës, me kërkesën e këtij të fundit, DPPI-ja i regjistron këto ndryshime në regjistrin e markave, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. DPPI-ja, me kërkesë të pronarit të markës, regjistron kufizimin e listës së mallrave dhe/ose shërbimeve në regjistrin e markave, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse."</u>	
--	--	--	--	---	--

120	02.05.2025	Jam i interesuar per informacion mbi markat tregatre, si mund ta rregjistroj	02.05.2025	Për informacion në lidhje me procedurën për regjistrimin e një marke, bashkëngjitur gjeni materialin informues.		
121	19.05.2025	Jam e interesuar te regjistroj nje marke tregtare ne Shqiperi . Marka do te perfaqesoje nje platforme online shit- blerje te produkteve te perdorura kryesisht veshje , kepuce dhe aksesore . A mund te me informoni mbi procedurat apo hapat zyrtare qe duhet te ndjeke , tarifat perkatese dhe menyren e dorezimit te aplikimit . gjithashtu , a mund te me konfirmoni nese eshte e mundur regjistrimi i nje marke nga nje person fizik pa basur nje NIPT	19.05.2025	ashkëngjitur gjeni materialin informues në lidhje me regjistrimin e markës tregtare. Aplikanti mund të jetë ose individ, ose subjekt tregtar.		
122	13.05.2025	Pasi bëhet aplikimi në DPPI si veprohet me procedurën? Sa kohë qëndron në status "në pritje" aplikimi?	19.05.2025	Bashkëngjitur gjeni materialin informues për regjistrimin e markës. Në rast se i referoheni një aplikimi të caktuar, për të cilin keni aplikuar dhe doni të dini statusin, lutemi të na dërgoni të dhënat e aplikimit.		

123	14.05.2025	Pershendetje isha interesuar per regjistrimin e nje marke por kam nje pyetje per regjistrimin nderkombetar te markes eshte e detyrueshme te bej regjistrimin kombetar te saj ? pra duhet ti bej te paren regjistrim kombetar pastaj nderkombetar? apo mund te bej direkt nderkombetar dhe ai e perfshin	19.05.2025	Në vijim të email-it tuaj, ju informojmë se: -Aplikimi për regjistrimin ndërkombëtar të një marke tregtare paraqitet pranë DPPI-së, e cila në këtë rast vepron jo si zyrë regjistrimi, por si zyrë pritëse e aplikimit. Depozitimi bëhet nëpërmjet platformës “e-Albania”. Aplikanti mund të jetë vetëm një person fizik ose juridik që plotëson kushtet më poshtë: 1. Ka qendrim të përhershëm ose një veprimtari tregtare ose industriale efektive në territorin shqiptar. dhe 2. Ka depozituar aplikimin për regjistrimin e markës (i cili ka plotësuar kërkesat e neneve 145, 146 e 150 të ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar) ose ka regjistruar markën tregtare në DPPI përpara datës së paraqitjes së aplikimit për regjistrimin ndërkombëtar të saj. -Për më shumë informacion, bashkëngjitur gjeni materialin informues për regjistrimin kombëtar dhe ndërkombëtar të markës tregtare.		
-----	------------	---	------------	---	--	--

124	16.05.2025	Jemi te interesuar per te aplikuar per nje produkt, ju lutem na jepni me shume informacion rreth procesit te aplikimit si dhe formularin e aplikimit. Me respekt,	19.05.2025	Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se: 1.Nëpërmjet shërbimit elektronik "Aplikim për regjistrim të treguesit gjeografik" jepet mundësia e aplikimit online për qytetarët dhe subjektet për regjistrimin e një treguesi gjeografik. Formulari i aplikimit shkarkohet në e-Albania, pasi plotësohen fushat e kërkuara. Baza ligjore: - Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; - Kodi i Procedurave Administrative; - VKM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, i ndryshuar"; Dokumentacioni që ngarkohet nga aplikanti: - Prova që produkti e ka origjinën nga zona gjeografike e përcaktuar; -Lidhja midis cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik ose lidhja midis një cilësie të caktuar, reputacionit ose karakteristikave të produktit me origjinën gjeografike; -Çdo rregull specifik për etiketimin e produktit në fjalë; - Dokumenti zyrtar që vërteton krijimin e		
-----	------------	--	------------	---	--	--

				grupit; -Një dokument të lëshuar nga autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë; -Autorizim përfaqësimi, nëse personi që aplikon përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar; -Dokumenti i pagesës së tarifës përkatëse; 2.Nëpërmjet shërbimit elektronik "Aplikim për regjistrim të emërimit të origjinës" jepet mundësia e aplikimit online për qytetarët dhe subjektet për regjistrimin e një emërtimi origjine. Formulari i aplikimit shkarkohet në e-Albania, pasi plotësohen fushat e kërkuara. <i>Baza ligjore:</i> - Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; - VKM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar; - Kodi i Procedurave Administrative. <i>Dokumentacioni që ngarkohet nga aplikanti:</i> - Prova që produkti e ka origjinën nga zona gjeografike e përcaktuar; - Lidhja midis cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik ose lidhja midis një cilësie të		
--	--	--	--	---	--	--

				caktuar, reputacionit ose karakteristikave të produktit me origjinën gjeografike; - Çdo rregull specifik për etiketimin e produktit në fjalë; - Dokumenti zyrtar që vërteton krijimin e grupit; - Një dokument të lëshuar nga autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë; - Autorizim përfaqësimi (nëse personi që aplikon përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar); Bashkëngjitur gjeni: - Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; - VKM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar; Në rast nevojë ose paqartësie, mund të kërkontë ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të certifikuar nga DPPI, të cilët janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës së pronësisë industriale. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://regjistriperf		
--	--	--	--	--	--	--

				aqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html .		
125	12.05.2025	Po ju dergojme kete kerkese per informacion, pasi deshirojme te bejme: • Aplikim per regjistrim nderkombetar te markes tregtare/disenjos industriale Per kete arsye, do te ju kerkonim nese eshte e mundur, te na udhezoni ne lidhje me dokumentacionin qe duhet te pergatisim, formulare, apo informacione te tjera te nevojshme.	19.05.2025	-Çdo aplikim, që prej datës 01.05.2022, kryhet online në portalin e-Albania. -Aplikimi për regjistrimin ndërkombëtar të markës tregtare dhe disenjës industriale përkohë në e-Albania me shërbimin: "Aplikim për regjistrim ndërkombëtar të markës tregtare/disenjos industriale". -Për informacion në lidhje me procedurën e regjistrimit ndërkombëtar të markës tregtare, bashkëngjitur gjeni broshurën me materialin informues. -Për procedurën e regjistrimit ndërkombëtar të disenjës industriale, dokumentacioni që ngarkohet nga aplikanti është: Formulari i përcaktuar nga Byroja Ndërkombëtare e WIPO-s, i cili gjendet në linkun: https://www.wipo.int/documents/d/hague-system/docs-en-form_dm_1-editable1.pdf Mandati i pagesës së tarifës përkatëse për llogari të WIPO-s;		

				Mandati i pagesës së tarifës përkatëse për ekzaminimin dhe përcjelljen e kërkesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale. -Bashkëngjitur gjeni: Ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; Faturën për arkëtim në DPPI. VKM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, i ndryshuar"; -Në rast nevojë ose paqartësie, mund të kërkonti ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të certifikuar nga DPPI, të cilët janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës së pronësisë industriale. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://regjistriperfaqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html .		
126	13.05.2025	Ju lutem kam nje pyetje mbi transferimin e pronesise industriale, Kompania ka blere me pare me kontrate dhe fature	19.05.2025	Ju informojmë se shërbimi për transferimin e pronësisë së një marke ofrohet në e-Albania në shërbimin " Aplikim për ndryshime në regjistrin e markave tregtare ".		

		disa Brande nga nje kompani, Por nuk ka bere ndryshimin tek ju te emrit te mbajtesit pavaresisht se ne kontabilitet jane perfshire por certifikatat tek ju i ka me emrin e kompanise tjeter. Nderkohe tani i jane shitur nje kompanie te re e cila do te ndryshoje emrin e mbajesit te brand-eve. Cfare dokumentash duhet te degohen dhe si behet transferimi ne kete rast sepse certifikatat nuk jane ne emrin e shitesit por ekzistojne kontatat dhe faturat e kryera.		Për të kryer aplikimin lutemi të konsultoheni me nenin 33, 34, 35 te VKM nr. 315, datë 31.5.2018 "Për miratimin e rregullores për markat", i ndryshuar dhe nenin 162 të ligjit nr. 9947, datë 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar. Dokumentacioni që ngarkohet nga aplikanti për regjistrimin në regjistër të ndryshimit në emër të pronarit të markës: - Akti i transferimit të pronësisë. - Autorizimi i përfaqësimit nëse aplikanti ka autorizuar një përfaqësues, ose aplikanti është jo resident në Shqipëri. Bashkëngjitur gjeni: - Ligji nr. 9947, datë 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; - VKM nr. 315 datë 31/05/2018 "Për Miratimin e Rregullores Për Markat"; - VKM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për Miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", i ndryshuar; -Faturën për arkëtim.		
127	29.05.2025	Ju drejtohem me kërkesën për të marrë informacion të detajuar mbi	29.05.2025	Bashkëngjitur gjeni materialin informues ne lidhje me aplikimin për		

		procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për mbrojtjen e logos së nje shoqate pranë institucionit tuaj. Logoja do të përdoret si shenjë identifikuese në veprimtarinë publike dhe institucionale të shoqatës, ndaj dëshirojmë të sigurojmë mbrojtjen e saj në përputhje me legjislacionin përkatës të pronësisë industriale. Do të ishim mirënjohës nëse do të mund të na informoni për: 1. Hapat që duhen ndjekur për aplikimin e logos si markë të regjistruar; 2. Dokumentacionin e kërkuar për subjektet jofitimprurëse; 3. Formatet apo formularët standard që duhen plotësuar; 4. Tarifën përkatëse për aplikimin dhe regjistrimin;		regjistrimin e markës tregtare. Në rast nevoje ose paqartësie, mund të kërkonti ndihmën e një prej përfaqësuesve të autorizuar, të certifikuar nga DPPI, të cilët janë profesionistë të lirë, specialistë të fushës së pronësisë industriale. Listën e përfaqësuesve të autorizuar e gjeni në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar, në faqen tonë web, në linkun: http://regjistriperfaqesuesvetepi.dppi.gov.al/index.html		
--	--	---	--	---	--	--

		5. Kohëzgjatjen e procedurës dhe mënyrën e dorëzimit të aplikimit (online ose pranë zyrave tuaja); 6. Nëse është e nevojshme përfaqësimi nga një përmbarues apo përfaqësues ligjor për këtë proces. 7. Cilat janë vendimet, shkresat dhe dokumentacioni ligjor i nevojshme që duhet paraqitur				
128	28.05.2025	Pershendetje isha e interesuar per procesin e aplikimit per trajnimin fillestar dhe me pas procedurat ne vazhdim per perfaqesuese e autorizuar.	29.05.2025	Për t'u trajnuar ju duhet të aplikoni në e-Albania shërbimin "Aplikim për pjesëmarrje në trajnim në Qendrën e Trajnimeve të Pronësisë Industriale në DPPI", ndërsa për t'u certifikuar si përfaqësues i autorizuar ju duhet të aplikoni shërbimin "Aplikim për pajisje me certifikatë si përfaqësues i autorizuar/ekspert i pronësisë industriale"		
129						

